



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 qershor 2014
Nr. ref.: RK654/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI225/13

Parashtrues

Hasan Isafi dhe Muharrem Isafi

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të
Kosovës, CA. nr. 972/2013, të 18 tetorit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Hasan Isafi dhe z. Muharrem Isafi, nga fshati Bec, komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), të cilët me autorizim i përfaqëson znj. Shahe Isafi nga fshati Bec, komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: përfaqësuesja e parashtruesve të kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 972/2013, të 18 tetorit 2013, të cilin parashtruesit e kërkesës pohojnë se e kanë pranuar më 2 nëntor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 972/2013, i 18 tetorit 2013, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesve, ishin shkelur neni 46 [Mbrojtja e Pronës], neni 24 [Barazia para Ligjit] dhe neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), për shkak të mosmarrëveshjes mbi të drejtën e pronës në mes të parashtruesve të kërkesës dhe personave të tretë.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 shkurt 2014, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 13 janar 2014, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI225/13, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI225/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 31 janar 2014, Gjykata Kushtetuese i njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, si dhe kërkoi nga përfaqësuesja e parashtruesve të kërkesës që të plotësonin formularin zyrtar të Gjykatës për regjistrim të kërkesës.
8. Më 10 shkurt 2014, përfaqësuesja e parashtruesve të kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin zyrtar të Gjykatës për regjistrim të kërkesës.
9. Më 20 shkurt 2014, Gjykata informoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 12 maj 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues Robert Carolan, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi, i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 19 shtator 2007, Gjykata Komunale në Gjakovë vendosi sipas padisë së H. I. nga fshati Bec, kundër parashtruesve të kërkesës, duke vërtetuar të drejtën e servitutit të H. I. në paluajtshmërinë e caktuar. Prona gjendet në ngastrën shërbyese nr. 245/11 KK Bec, me fillim nga rruga publike që është e regjistruar si ngastër kadastrale nr. 247 KK Bec. Ajo gjykatë nxori Aktgjykimin C. nr. 43/07, i cili vërteton të drejtën e servitutit të rrugëkalimit për paditësin H. I. Gjykata Komunale në Gjakovë më tej theksoi:

“Gjykata analizoj edhe variante të tjera të paraqitura në ekspertiza ... por erdh tek përfundimi se varianti i aprovuar ka ekzistuar që nga ndarja e paraardhësve të ndërgjyqësve...”

12. Më 3 shkurt 2009, Gjykata e Qarkut në Pejë vendosi sipas ankesave të parashtruesve të kërkesës kundër Aktgjykimit C. nr. 43/07, të 19 shtatorit 2007, duke nxjerrë Aktgjykimin Ac. nr. 308/09 dhe duke refuzuar këto ankesa si të pabazuara. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata e Qarkut në Pejë më tej theksoi:

“Aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, kurse në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, gjykata e qarkut në kuptim të nenit 368 të LPC i refuzoi ankesat e të autorizuarve të paditurve, kurse aktgjykimin e atakuar e aprovoi”

13. Më 18 mars 2009, Gjykata Komunale në Gjakovë vendosi sipas kërkesës për revizion të parashtruesve të kërkesës, me Aktvendimin C. nr. 43/07. Në atë Aktvendim, ajo i hodhi poshtë revizionet e parashtruesve të kërkesës si të palejuara me arsyetimin si në vijim:

“Revizionet e parashtruara nga ana të autorizuarve të paditurve janë të palejuar, bazuar në nenin 382 të ish Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe Urdhëresës Administrative nr. 200110 të datës 21 qershor 2001.... për valutën e lejuar për përdorim në Kosovë ka qënë e paraparë vlera 1600 DM, e cila vlerë kontesti duhet të i përshtatet vlerës së shprehur në euro...”

14. Më 9 qershor 2009, Gjykata e Qarkut në Pejë, duke vepruar në bazë të ankesës së parashtruesve të kërkesës, nxori Aktvendimin Ac. nr. 194/09, dhe i refuzoi ankesat si të pabazuara duke theksuar:

“Aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, kurse në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, Gjykata e qarkut në kuptim të nenit 380 al. 1 pika 2 të LPK refuzoi ankesat e të autorizuarve të paditurve kurse aktvendimin e atakuar e vërtetoi”

15. Më 10 shtator 2012, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi lidhur me revizionin e parashtruesve të kërkesës përmes Aktvendimit Rev. nr. 432/2009, duke e refuzuar si të pabazuar revizionin dhe vërtetoi Aktvendimin Ac. nr. 194/09, të 9 qershorit 2009, të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

16. Më 22 mars 2013, Gjykata Themelore në Gjakovë, duke vepruar në bazë të kundërshtimit të parashtruesve të kërkesës në çështjen përmbartimore, nxori Aktvendimin E. nr. 368/09, me të cilin refuzoi si të pabazuar kundërshtimin e parashtruesve të kërkesës, me të cilin është lejuar përmbartimi sipas propozimit të H. I., bazuar në Aktgjykimin C. nr. 43/07, të 19 shtatorit 2007.
17. Më 18 tetor 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës vendosi në bazë të ankesës së parashtruesve të kërkesës të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, E. nr. 368/09, të 22 marsit 2013 dhe nxori Aktvendimin CA. nr. 972/2013, duke refuzuar ankesën si të pathemeltë. Gjykata më tej theksoi:

“Këtë qëndrim të gjykatës së shkallës së parë, kolegji e vlerëson të drejtë dhe të bazuar në ligj, pasi që vendimi gjyqësor në bazë të cilit është caktuar përmbartimi, është i formës së prerë, dhe ka kaluar, afati për përmbushjen vullnetare, të obligimit të caktuarën titullin përmbartimorë sipas të cilit debitorët, kanë për detyrë të respektojnë të drejtën e servitutit të kreditorit H.I, sipas dispozitivit të aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale të Gjakovës C. Nr. 43/07 të dt. 19.09.2007”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesit pretendojnë se:

“Sipas Aktvendimeve të lartë cekura mendoj se është shkelur neni 46 i Kushtetutës së Kosovës nga pika 1, 2 dhe 3, Neni 24 pika 1 dhe 2 si dhe Neni 31 sepse palëve në rastin e parë dhe të dytë nuk u ka mundësuar që të mbrojnë pronën e vet edhe përkundër faktit se ata kanë paraqitur fakte të reja lidhur me këtë çështje...”.

19. Parashtruesit arrijnë në përfundim duke kërkuar nga Gjykata:

“... anulimin e vendimeve të mara nga Gjykata dhe kthimin e lëndëve në shkallën e parë për rishqyrtim dhe rivendosje dhe gjykim të drejtë dhe të paanshëm të pa ndikuar nga jashtë...”.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje të vendosë për kërkesën e parashtruesve të kërkesës, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesit i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen me Kushtetutë dhe specifikohen më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
21. Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, i cili përcakton që:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Në lidhje me këto kërkesa, Gjykata vëren që parashtruesit janë persona fizikë, si dhe janë palë të autorizuar në pajtim me nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

22. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu duhet të vërtetojnë që i kanë përmbushur kërkesat e nenit 49 të Ligjit, në lidhje me dorëzimin e kërkesës brenda afatit të caktuar. Mund të shihet nga shkresat e rastit se nuk ka asnjë provë që do të kontestonte pretendimet e parashtruesve që, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 972/203, të 18 tetorit 2013, ata e kanë pranuar më 2 nëntor 2013, andaj kërkesa është dorëzuar brenda afatit prej 4 (katër) muajve, siç përcaktohet me Ligj dhe me Rregullore të punës.
23. Në lidhje me kërkesën, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton që:

*“(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...], ose
(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose
[...], ose
(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
24. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i këtyre të fundit që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, para. 28, shih edhe *Rastin nr. KI70/11*, parashtruesit *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
25. Gjykata Kushtetuese mund vetëm të trajtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë sa që parashtruesit të kenë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, Kërkesa e 10 korrikut 1991).
26. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vëren që arsyetimi i dhënë në aktgjykimin e nxjerrë nga Gjykata e Apelit e Kosovës është i qartë, si dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu ka gjetur që procedurat pranë gjykatave të rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009). Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë prezantuar argumente bindëse që do të mbështesnin shkeljet e pretenduara.
27. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës nuk kanë dorëzuar ndonjë provë *prima facie* që do të vërtetonte shkeljen e të drejtave të tyre sipas Kushtetutës (shih

Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së lidhur me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, i 31 majit 2005).

28. Për të gjitha arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron që faktet e prezantuara nga parashtruesit e kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkelje të të drejtave kushtetuese dhe parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 12 maj 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani